

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -I-RË E JASHTËZAKONSHME E -IX-TA ME RADHË E
KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 16 TETOR 2019**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 8:55.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Fitim Halili, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Rrezarta Krasniqi, Gresa Muli, Habibe Gërxfhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Selim Rustemi Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Ali Januzi, Hysni Gërguri, Miljan Bojković dhe Gentiana Rama.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës -z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës z.Besim Muzaqi, përfaqësuesi i kompanisë “Emona”, përfaqësuesi i kompanisë kroate “Conex Trade” d.o.o, përfaqësuesi i kompanisë spanjolle, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 31 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Në vazhdim kuvendi pas deklarimit në mënyrë unanime aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i kërkesës të Kompanisë “Emona” SH.P.K (Emona Group) në Vushtri, kompanisë kroate “Conex Trade” d.o.o dhe kompanisë spanjolle, për dhënie në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të tokës në pronësi të komunës, për realizim të projektit “Ndërtimi i fabrikës për përpunimin e peshkut të detit”.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-pasi përshëndeti të pranishmit, në adresimin e tij për para kuvendit ceku se një nga detyrat themelore të komunës dhe të kryetarit të saj është krijimi i mundësive për biznesin privat që krijon vende të reja të punës. Përdorimi i aseteve komunale, siç është toka në pronësi të komunës në funksion të zhvillimit ekonomik të komunës dhe krijimit të vendeve të punës, është po ashtu një nga misionet themelore që kemi si qeveri

komunale. Në këto dy vite jemi përpjekur vazhdimisht që të krijojmë një ambient për të bërë biznes për të krijuar mundësi dhe kushte sa më të favorshme për biznesin, por edhe për investitorët e brendshëm dhe të jashtëm që kanë për qëllim dhe synim krijimin e vendeve të punës, për të rinjtë tanë, për gratë dhe për gjithë qytetarët e komunës sonë. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, si kryetar i komunës kam pranuar kërkesën nga kompania "Emona" SH.P.K bashkë me partnerët e tyre "Conex Trade" d.o.o nga Kroacia dhe "Connorosa" S.A nga Spanja, për të caktuar një lokacion brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë, me qëllim të ndërtimit të një fabrike për përpunimin e peshkut të detit. Në përputhje me Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, kam zhvilluar negociatat e drejtpërdrejta me investitorët dhe përfaqësuesit e tyre, pasi ka pranuar kërkesën me shkrim për një gjë të tillë, tha Tahiri. Në fazat e caktuara të kësaj procedure, kam takuar komisionin komunal të zgjedhur nga kuvendi i komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, ku i kam njoftuar me kërkesën e këtyre investitorëve dhe po ashtu me kërkesat specifike që i kanë këta investitorë, shprehet Xhaferi. Sipas tij, në bazë të kërkesës së investitorëve do të punësohen 400 deri në 500 punëtorë, kryesisht nga Komuna e Vushtrrisë, ndërsa si fazë fillestare janë planifikuar të punësohen 208 punëtorë në këtë fabrikë. Sipas zotimit të kompanisë, në kërkesën që ju kemi dërguar, vlera e këtij investimi është 7, 121,552 €, prej të cilave vlera e aseteve fikse është 5,749,601 €.

Lidhur me këtë investim është thirrur kjo mbledhje e jashtëzakonshme e kuvendit, për ta shqyrtuar këtë kërkesë dhe për ta vendosur bashkërisht këtë çështje. Para jush janë përfaqësuesit e kompanive investuese, të cilët do sqarojnë konceptin e tyre lidhur me projektin investiv. Këta përfaqësues janë të gatshëm të përgjigjen pyetjeve tuaja, deklaroi Tahiri. Në fund ai falënderoi të gjithë për kontributin e dhënë lidhur me përpjekjet për zhvillimin e komunës tonë, për krijimin e mundësive për punësim sidomos të grave, sepse sipas planit të biznesit që është paraqitur në këtë fabrikë kryesisht do të punësohen gratë, sepse ne të gjithë e dimë që gratë dhe të rinjtë janë kategoria më e goditur nga papunësia në Republikën e Kosovës, por edhe në qytetin tonë. Andaj edhe një herë ai bëri thirrje që të përkrahet propozimi për ndarjen e kësaj prone komunale, sipas qirasë vjetore për hektar që aplikohet në atë territor, ashtu që ky projekt të jetësohet. Krejt në fund ai falënderoi kompanitë investive, kompaninë "Emona" SH.P.K kompani vendore "Conex Trade" d.o.o nga Kroacia dhe "Connorosa" S.A nga Spanja, për besimin e treguar ndaj Komunës së Vushtrrisë dhe i siguroi se do ta kenë përkrahjen e tij të plotë në çdo hap deri në realizimin e plotë të këtij investimi.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –pasi përshëndeti të pranishmit në veçanti investitorët e mundshëm nga Republika mike e Kroacisë, ajo e Spanjës dhe përfaqësuesit të kompanisë "Emona" Group ju shprehi mirëseardhje në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë. Grupi kuvendar i PDK-së si grupi më i madh kuvendar është i njoftuar me negociatat që janë zhvilluar deri më tani e edhe pse dihet se nuk kemi përfaqësues nga subjekti jonë politik në komisionin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Ai tha se kanë zhvilluar takime me grupin kuvendar të PDK-së dhe qeverinë komunale dhe ne gjithsesi do të përkrahim dhe do të japim kontributin tonë çdoherë kur respektohet ligji dhe është interesi publik në pyetje. Andaj, konsiderojmë se kryetari i komunës pasi ka zhvilluar negociatat me palët të cilat kanë shpreh interes për investim në komunën tonë, ka respektuar kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar edhe në Planin Zhvillimor Komunal dhe Ligji nr.06/1-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Sipas informatave që posedoj dhe kam grumbulluar e janë të sigurta, kompania Kroate "Conex Trade" ka një eksperiencë të gjatë të përpunimit dhe paketimit të peshkut dhe është ndër kompanitë me renome në Republikën e Kroacisë.

Ne e dimë se për të zhvilluar me sukses një projekt të tillë duhet të plotësohen shumë kritere e kushte ndër kryesoret po përmendi:

➤ Duhet të krijohet një sistem adekuat për shkarkimin e ujërave industriale duke qenë se është një ndër problematikat kryesore të kësaj fushe;

➤ Duhet të ketë furnizim me energji elektrike pa ndërprerje dhe

➤ Duhet të ketë një rrjet me furnizim me ujë pandërprerë.

Unë kam vetëm dy pyetje për investitorin:

1. A mund të na thoni pse keni kërkuar hapësirën e përgjithshme prej 30.000 m² d.m.th 3 hektarë, pasi që planifikimet tuaja janë të ndërtoni objekt të mbuluar sipas standardeve me hapësirë 5.000m² d.m.th 50 ari?

2. A jeni të gatshëm që të na bindni se vërtet do të kryhet ky investim? Nëse po, unë po propozoj që në vendim për dhënien afatgjate në shfrytëzim të pronës komunale të shtohet një pike në këtë vendim dhe të theksohet: para nënshkrimit të kontratës investitori do të jetë i obliguar të depozitoj garancion me kërkesë të parë në vlerë 100.000,00 € nga një bankë kredibile e Kosovës për periudhën 30 mujore, sa edhe mund të zgjas implementimi me sukses i këtij projekti. Konsideroj se një vlerësim strategjik mjedisor do duhej të bëhet paraprakisht, ndër të tjera, për strategjitë, planet dhe programet, përfshirë edhe gjendjen aktuale në terren, tha Azemi.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se pas konsultave që kanë pasur me grupin e tij politik në LDK, si dhe pas takimit informues në Komisionin Komunal për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim, me kryetarin e komunës dhe me kompanitë investuese, kanë marrë qëndrim se si grup kuvendar do ti japin mbështetje të fuqishme këtij projekti.

Latif Resyli, drejtor ekzekutiv i kompanisë "Emona"-në adresimin e tij para kuvendit, falënderoi Komunën e Vushtrrisë e veçanërisht kryetarin e komunës, për gatishmërinë që ta shtyjë përpara këtë projekt. Tutje shtoi se arsyeja se përse ka vendosur të vinë në këtë mbledhje të kuvendit është ekskluzivisht transparencë. Arsyeja se përse kanë vendosur të futen në këtë projekt është shumë spontane. Me partnerin "Conex Trade" kemi më tepër se 3 vjet që operojnë bashkë dhe për këtë kohë ata kanë bërë një punë relativisht të mirë. Gjatë një takimi të nivelit biznesor, në Split-Kroaci, është hedh ideja që një projekt i tillë të zhvillohet në ndonjë vend të rajonit tonë, dhe përfaqësuesit e Kompanisë "Emona" i kishin sugjeruar që një projekt i tillë të bëhet në Kosovë, për çka edhe ishin pajtuar. Gjatë elaborimit të këtij projekti, ajo që u kishte lënë përshtypje ishte numri i të punësuarve dhe struktura e të punësuarve. Ajo çka e bënë këtë projekt më atraktiv për Komunën e Vushtrrisë është për faktin se në këtë fabrikë do të punësohen kryesisht gra, dhe atë të moshave nga 40-50 vjeçare të cilat realisht janë të lëna pas dore, e që shumica prej tyre janë në fakt produktive. Mandej vlerësoi se kanë arritur që partnerët e tyre afarist t'i bindin se njëmend ja vlen të investohet në Kosovë, për faktin se fuqia punëtore është më e favorshme krahasuar me regjionin apo me Kroacinë.

Kompania "Conex Trade" është shumë profesionale në kategorinë e produkteve me të cilat merret. Pronari i "Conex" ka flotën e vetë të anijeve tre prej tyre i ka në pronësi të tij, ndërsa 22 tjera i ka me qira. Sipas ligjeve të BE-së është një maksimum, i cili nuk guxon të tejkalohet sa i përket anijeve në tregun e Detit Adriatik. Peshku, i cili ka me u përpunuar në Kosovë quhet "Inçun", ndërsa tregu në të cilin do të plasohet ky produkt është kryesisht Spanja, i cili është një treg shumë atraktiv. Sa i përket sipërfaqes së pronës që kërkohet nga kompania për tu marr në shfrytëzim, ceku se në kërkesë ka ndodhur një gabim, sepse nuk duhet të jenë 3 hektarë, por 5 hektarë për realizimin e këtij projekti. Lidhur me kriteret mjedisore që kërkohen, ai njoftoi se ky projekt do të bëhet konform legjislacionit të Republikës së Kosovës, duke u pajisur me leje përkatëse nga ministritë gjegjëse, për të cilat kërkoi asistencën e komunës në tejkalimin e

burokracive të panevojshme. Në fund tha se prej momentit të marrjes së pëlqimit brenda 6 muajve do të fillohet ky projekt, ndërsa dinamika e tij do të jetë deri në 2 vjet, ndërsa punëtorët do të trajtohen në mënyrë të dinjitetshme sipas ligjeve në fuqi.

Mladen Milakovic, përfaqësues i kompanisë "Conex Trade"-paraqiti një historik të themelimit dhe funksionimit të kompanisë së tij në Republikën e Kroacisë. Tutje shtoi se në këtë projekt do të investoj bashkë me një kompani spanjolle, e cila edhe e ka siguruar tregun e plotë për produktet e peshkut. Ai tha se në fabrikë do të punësoj rreth 208 punëtorë vushtrias, derisa me rritjen e kapaciteteve mendon që numri i të punësuarve (kryesisht gra) pritet të arrijë 400 deri në 500 punëtorë. Në vazhdim, ai njoftoi se ka hasur në vështirësi derisa i ka bindur partnerët spanjoll që të investojnë në Kosovë. Faktor kyç në këtë projekt është fuqia e lirë punëtore në Kosovë, dhe sigurimi i tregut në Spanjë, ku vetë në produktin e peshkut-"Sardenja" brenda një viti në Spanjë konsumohet 290 milion copë të këtij peshku. Pastaj njoftoi se vitin e kaluar "Conex Trade" ka pasur rreth 11 milion euro eksport, kurse këtë vit mendon që ky eksport të rritet në 14 milion euro. Sa i përket mbrojtjes së ambientit, ai tha se fabrika dhe produkti final do të bëhet konform kriterëve të ISO, për standardizim të ushqimit dhe kushtet tjera sanitare. Lidhur me ujin dhe ambientin përreth ekziston një tjetër certifikatë ISO, në cilën nëse një linje e prodhimit nuk i përmbushë ato standarde të Bashkësisë Evropiane, nuk mund të plasohet produkti në tregun e Bashkësisë Evropiane. Se sa do të jetë ky projekt ekologjik, kjo do të bëhet në pajtueshmëri me normat e Bashkimit Evropian, në lidhje me mbrojtjen e ambientit. Tek çështja tjetër se përse nevojiten 50.000.00 m² sipërfaqe, ai tha se për ngritjen e kësaj fabrike nevojiten 5000 m², ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes duhet të jetë përreth objekti për tu zhvilluar aktiviteti. Lidhur me të punësuarit, ai tha se ideja fillestare është që në një ndërrim të punësohen 200 punëtorë, në dy ndërrime, 400 punëtorë në të njëjtin objekt, dhe nëse krejt shkon ashtu siç është planifikuar, ai ka edhe dy apo tre partner tjerë në Spanjë që po presin dhe që janë shumë të interesuar për përpunimin e produktit të peshkut këtu në Kosovë, e që shumë shpejt kishin me filluar ndërtimin e një apo dy objekteve në Kosovë. Kur bëhet fjalë për garancionin prej 100.000.00€, ai tha se sa i përket kompanisë "Conex Trade" ky garancion nuk do të paraqiste kurrfarë problemi, dhe atë ditë që do të merret leja ndërtimore po atë ditë do të paguhet garancioni.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-pasi falënderoi të gjitha grupet kuvendare për mbështetjen e këtij projekti, sqaroi se deri më tani nuk ka qenë praktikë e kuvendit që dhënien e pronës komunale në shfrytëzim ta bëjë me garancion bankar, nëse një gjë e tillë kërkohet në saje të ligjit, një gjë e tillë do të bëhet atëherë kur komuna do të akordoj marrëdhënie kontraktuale me kompanitë respektive.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se si grup kuvendar i LVV-së, e mirëpresin dhe i japin mbështetje të plotë këtij projekti, por si grup politik kërkojnë nga ana e investitorëve një shkresë zyrtare me të cilën zotohen se pas marrjes së pronës në shfrytëzim nuk do të ketë ndryshim të destinimit të projektit, ku do të ceket kohëzgjatja e implementimit dhe nëse implementimi i projekti vonon pa arsye më shumë se sa koha e planifikuar, prona ti kthehet komunës, gjithashtu të garantohet edhe numri i punëtorëve.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit- pyeti investitorin se a do të ishin të gatshëm ta nënshkruanin kontratën nëse në të do të futet një nen ku thuhet se nëse kompanitë në fjalë nuk do të arrijnë që brenda afatit dy vjeçar të kryhet ky projekt, ta ketë mundësinë komuna ta ndërpres kontratën?

Pastaj ashtu siç është bërë e ditur përmes kërkesës që numri i punëtorëve në fillim do të jetë 208 e në fazën e më vonshme 400 deri në 500, andaj pyetja është që këta 208 punëtorë të saktësohet se për sa kohë do të punësohen, dhe përsëriti se a do të ishin të gatshëm të nënshkruanin kontratën, pasi këtu kuvendi do ta autorizoj kryetarin e komunës për nënshkrimin e kësaj kontrate. Gjithashtu ceku se investitorët a do të jenë të gatshëm të nënshkruajnë kontratën nëse në të do futej një klauzolë ku do të përcaktohet se nëse investitorët nuk e kryejnë

këtë projekt për afatin prej dy viteve, atëherë komuna të ketë të drejtën që njëanshëm ta shkëpusë kontratën.

Latif Resyli, drejtor ekzekutiv i kompanisë “Emona”-njoftoi se edhe në takimet tjera me zyrtarët e lartë komunal, kanë siguruar dhe në të njëjtën kohë është edhe interes i kompanive që ky projekt të mos stërgjatët. Lidhur me nenin i cili ka të bëjë me shkëputjen e kontratës në mënyrë të njëanshme bëri të ditur se janë gatshëm që nënshkruajnë një gjë të tillë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit –tha se është hera e parë që një kompani kaq serioze i është ofruar Komunës së Vushtrrisë për të investuar siç është kompania “Conex Trade”, dhe kjo është tepër e mirëseardhur për ne si kuvend dhe si komunë në tërësi. Andaj, lidhur me këtë ai kërkoi që këtij projekti ti jepet përkrahje e plotë nga të gjithë, dhe për këtë fare të mos ketë diskutime, sepse nëse shtrohet nevoja për analizim të kësaj çështje, atëherë mund të thirren grupet kuvendare të partive politike të përfaqësuar në kuvend për shqyrtuar më tej këtë çështje. Lidhur me temat dhe kërkesat që ju drejtuan investitorit, vlerësoi se kërkesat e tilla mund të vendosen si obligime kontraktuese, para nënshkrimit të kontratës mes Komunës së Vushtrrisë dhe investitorëve në fjalë.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit-pyeti se para kësaj mbledhje kuvendi ka vendosur që këtë pronë ta jap në shfrytëzim për 40 vite, ndërsa tani kërkesa e kompanisë është që kjo pronë të jepet në shfrytëzim për 99 vite, për këtë kërkoi sqarime procedurale lidhu me këtë temë sa i përket afateve.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-falënderoi investitorët që kanë shprehur besimin e tyre, për të investuar në Komunën e Vushtrrisë. Tutje shtoi se duke siguruar kuvendin dhe të gjithë qytetarët e Vushtrrisë, se kontrata me këto kompani do të jetë publike dhe e qasshme për secilin qytetar të Komunës Vushtrrisë, sikur që do të jenë publike çdo dokument lidhur me projektin dhe çdo tjetër që lidhet me realizimin e këtij investimit. Më tej tha se çdo gjë lidhur me këtë projekt do të jetë në transparencë të plotë me qëllim të rritjes së besueshmërisë për investitorët e jashtëm. Afati i dhënies së kësaj prone do të jetë 40 vite konform ligjit në fuqi, dhe pas këtij afati mund të vazhdohet varësisht prej interesit të komunës. Në fund ai falënderoi investitorët dhe të gjithë anëtarët e kuvendit për mbështetjen unanime për këtë projekt dhe ceku se si kryetar i komunës do ta përkrah deri në fund këtë investim me qëllim të realizimit, dhe rritjes së zhvillimit ekonomik dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës.

Mladen Milakovic, përfaqësues i kompanisë “Conex Trade”-tha se të njëjtat procedura që janë zhvilluar në Kroaci, të njëjta do të aplikohen edhe në Kosovë, dhe nëse nuk plotësohet numri i punëtorëve i paraparë në kontratë, atëherë kompania është e gatshme të bëjë kompensimin e dhjetëfishtë të dëmeve eventuale.


Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas deklarimit nga gjithsej 31 anëtarë të kuvendit sa ishin prezent në mbledhjen plenare në mënyrë “unanime” u vendos me sa vijon:

1. Aprovohet oferta e negociuar nga Kryetari i komunës dhe jepet në shfrytëzim me kompensim parcela kadastrale P-70202022-00512-1, ZK-Gracë, pronë e Komunës së Vushtrrisë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 53693 m².
2. Paluajtshmëria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin me kompensim, në afat prej 40 vitesh, Kompanisë “Emona” SH. P.K (Emona Group) me seli në Vushtrri, në partneritet me kompaninë kroate “Conex Trade” d.o.o dhe kompaninë spanjolle “Connorosa S.A” për ndërtimin e fabrikës për përpunimin e peshkut të detit, si ofertë e përzgjedhur e paraqitur në negociatat e drejtpërdrejta të Kryetarit të komunës.
3. Çmimi vjetor i qirasë është treqind euro (300 €) për një (1) hektar.

4. Obligohet Kryetari i komunës të lidhë kontratë për dhënien me qira të pronës komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, me ofertuesin e përzgjedhur në negociata të drejtpërdrejta nga Kryetari i komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikata e pronës, kopja e planit, kërkesa dhe procesverbali nga shqyrtimi i ofertave të drejtpërdrejta nga Kryetari i komunës.
7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Mbledhja përfundoi në orën 9:45.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

